



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije/Ministry of Economy

THIRRJE PUBLIKE

për shprehje të interesit për aplikim për Emërimin e Trupit për Vlerësim të Konformitetit të Ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara dhe shërbimeve të besuara të kualifikuara

Nr.01/2023

Prishtinë, 19.05.2023

Bazuar në nenin 4 paragrafi 2 të Rregullores (ME) Nr. 10/2022 për Vlerësimin e konformitetit të ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara dhe shërbimeve të besuara dhe të kualifikuara si dhe sigurimi nga rreziku dhe dëmet e shkaktuara nga ofrimi i shërbimit të besuar dhe të kualifikuar.

Ministria e Ekonomisë, shpall Thirrje Publike për emërimin e Trupit për Vlerësimin e Konformitetit.

1. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1.1. Certifikata e Regjistrimit të biznesit;

1.2. Certifikata e akreditimit sipas standardit EN ISO/IEC 17065 dhe për pajisjet e përdorura për testim certifikatën -EN ISO/IEC 17025 të lëshuar nga një Drejtoria e Akreditimit;

1.3. Numri dhe emri i Ligjit dhe Rregullores sipas të cilës bëhet emërimi;

1.4. Fushë veprimtarinë përkatëse për vlerësim të konformitetit, llojin e aktiviteteve që kryen, emrin e modulit për vlerësimin e konformitetit;

1.5. Të dhënat për kompetencën teknike të punonjësve dhe të personave të tjerë të angazhuar në aktivitetet e vlerësimit të konformitetit;

1.6. Të dhënat për kapacitetet teknike dhe procedurale, përfshirë pajisjet dhe vendin në të cilën do të kryhen aktivitetet e vlerësimit të konformitetit;

1.7. Deklaratën se nuk është i përfshirë në aktivitete të cilat mund të bien ndesh me pavarësinë dhe paanshmërinë e vlerësimit të konformitetit;

1.8. Deklaratën e zbatimit të kërkesave të standardit ETSI EN 319 403;

1.9. Policën e sigurimit ose garancinë bankar në vlerë prej 100,000.00 € të përgjegjësisë për mbulimin e dëmit që mund të shkaktohet;

(pas përzgjedhjes nga Komisioni për emërimin e Trupit për Vlerësimin e Konformitetit).

2. Trupi aplikues për Vlerësimin e konformitetit duhet t'i bashkëngjësë kërkesës për aplikim të gjitha dokumentet në formë origjinale ose në kopje e noterizuar me të cilat vërtetohen të dhënat nga kërkesat sipas paragrafit 1 të kësaj thirrje për të cilat trupi aplikues pretendon të jetë kompetent.

3. Detyrat dhe obligimet e trupit për vlerësimin e konformitetit janë të përcaktuara në nenin 9 të Rregullores (ME) Nr. 10/2022 për vlerësimin e konformitetit të ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara dhe shërbimeve të besuara dhe të kualifikuara si dhe sigurimi nga rreziku dhe dëmet e shkaktuara nga ofrimi i shërbimit të besuar dhe të kualifikuar sipas linkut si në vijim: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51618>

4. Të drejtë aplikimi kanë:

4.1 Trupat për Vlerësimin e Konformitetit që janë akredituar nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës, dhe

4.2 Trupat e huaj për Vlerësimin e Konformitetit nga vendet anëtare të BE-së për të cilat paraprakisht është kryer verifikimi nga Drejtoria e Akreditimit.

4.3 Trupat e huaj për Vlerësimin e Konformitetit nga vendet jo anëtare të BE-së, nëse Kosova ka marrëveshje reciproke për njohjen e shërbimeve të besuara të kualifikuara dhe të cilat janë të verifikuara nga Drejtoria e Akreditimit.

5. E drejta për ankesë:

Aplikantët të cilët vlerësojnë se aplikimi i tyre nuk është vlerësuar drejtë nga Komisioni përkatës i Ministrisë, mund të ushtrojnë të drejtën e Ankesës në afat prej 30 ditësh, konform Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Ankesa i drejtohet Ministrisë së Ekonomisë si autoritet që ka publikuar Thirrjen.

6. Informata shtesë:

Dokumentacioni i kërkuar për aplikim mund të dërgohet në adresën elektronike:

ajshe.jashari@rks-gov.net apo përmes dorëzimit të kopjes fizike në adresën: *Ministria e*

Ekonomisë, sheshi “Nëna Terezë”, nr. 36, Prishtinë, Arkivi i ME-së.

Aplikimi është i hapur nga data 19/05/2023 deri me 19/06/2023 deri në orën 24.00.

Për informacione shtesë mund të thirrni në numrin e telefonit + 383 (0) 38 200 215 85 nga ora 08:00 -16:00 nga e hëna deri të premten.